



KOMUNA E KLINËS
KUVENDI I KOMUNËS

01.06-3960/17

KLINË, 29.6.2017

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

I SEANCËS SË VI-të TË KK, MBAJTUR, MË 29.6.2017, NË ORËN 10.00, NË SALLËN E
KK

Në seancë prezantuan: Kryetari i Komunës, Sokol Bashota, kryesuesi i KK, Dr. Haxhi Ibishi, nënkryetari i Komunës, Enver Berisha, anëtarët e KK, drejtorë të drejtorive, Zyra ligjore, KFOR-i, OSBE, OJQ "Koha" etj.

Seancën e hapi dhe udhëhoqi kryesuesi i KK, dr. Haxhi Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe ju uroj mirëseardhje në këtë seancë të KK.

Kryesuesi hapi diskutimin rreth rendit të propozuar të ditës.

Skënder Merturi, prezantoi vërejtje për mospjesëmarrjen e kryetarit të Komunës, Sokol Bashota, në shënimin e Ditës së Çlirimit të Klinës.

Sokol Bashota, duke iu kundërvënë reagimit të anëtarit Merturi, pohoi se kjo çështje është imja personale, është agjendë imja, theksoi kryetari, i cili në vijim foli rreth iniciativës së OJQ "Koha", rreth zgjedhjes së kryetarëve të katër fshatra të Komunës së Klinës "Kjo iniciativë e zgjedhjes së këtyre kryetarëve dhe këshillave të fshatrave pa marrëveshje me ne është inekzistente" është shprehur kryetari Bashota.

Tunë Dedaj, tha se kërkoj që të qitet në rend të ditës zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave, kur të tjerët përpos KK nuk kanë legjitimitetin për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave.

Haxhi Ibishi, sqaroi se kemi zgjedhur një komision me ekzekutivin dhe KK, prandaj mendoj që Ekzekutivi, KK dhe OJQ "Koha" të bashkëpunojnë.

Fadil Gashi, tha se ne kemi formuar një komision, qenka shqetësim real, si dhe me çfarë të drejte ajo ministri merr vendime të tilla. "E kemi problemin me atë ministri, qysh e ka lëshuar

atëshkresë. Ne si KK jemi ata që e kemi themeluar komisionin, ta shohim atë pëlqim. Tëpërfshihet në pikën, Të ndryshme, të sqarohet”, pohoi anëtari Gashi.

Ramush Agushi, theksoi se jemi takuar me udhëheqësin e OJQ “Koha”, z. Elbasan Racajn, dhe kemi biseduar rreth kësaj çështjeje “ Na është thënë së MPL e mbështet OJQ “Kohën”, për zgjedhjen e katër kryetarëve në fshatrat e Komunës së Klinës”, sqaroi ndër të tjera anëtari Agushi.

Ndue Shabanaj, theksoi se nga kjo që po rrjedh këtu po del që me këtë rast është një bashkëpunim më i ngushtë i ministrisë me OJQ “Koha”, se sa me pushtetin lokal. Po pajtohem që komisioni është legjitim ose duhet shkarkuar. Është me interes për t’u formuar dhe nëse është siguruar buxheti le të implementohet”, konstatoi ndër të tjera prof. Shabanaj.

Skënder Merturi, the se është formuar komisioni, ajo trupë është formuar, OJQ koha ka fituar tenderin nga MPL le të punojë, pse të diskutojmë këtu kur e kemi votuar, - theksoi anëtari Merturi.

Haxhi Ibishi, foli rreth çështjes në debat. “Është pilot-projekt, vendimi i këtij Kuvendi nuk mund të kontestohet”, theksoi kryesuesi Ibishi.

Sokol Bashota, tha se me këtë rast çështjet bien ndesh, unë nuk kam qenë i informuar, kryetarët janë të obliguar të njoftohen, po ashtu edhe kryetari i Komisionit, anëtar i Komisionit është edhe përfaqësuesi i OJQ “Koha”, të futet në pikën e rendit të ditës, Të ndryshme, Informatë rreth zgjedhjes së Këshillave të fshatrave dhe procedurave gjegjëse”, shtoi kryetari Bashota.

Kryesuesi vuri në miratim rendin e ditës, me plotësimin e pikës, Të ndryshme, Informatë rreth zgjedhjes së Këshillave të fshatrave dhe procedurave gjegjëse.

Me vota unanime u miratua ky

RENDI I DITËS

- 1. Arsyetimi i mungesave**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,**
- 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-strategjisë për Zhvillimit Ekonomik të Komunës 2017-2021,**
- 4. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore – KAB - periudha 2018-2020,**
- 5. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Klinës 2017,**
- 6. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për vënie në diskutim publik të Projekt-rregullores për Pronën e Paluajtshme,**
- 7. Raportimi i Kryetarit për situatën ekonomiko-financiare të Komunës dhe zbatimit i planeve investuese të Komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2017,**

8. Të ndryshme: Informatë rreth zgjedhjes së Këshillave të fshatrave dhe procedurave gjegjëse.

Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.

Kryesuesi sqaroi që ka mungesë për anëtarin Avni Gashi.

Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Kryesuesi hapi debatin rreth procesverbalit të seancës së kaluar. Nuk pati debate. Kryesuesi vuri në miratim procesverbalin e seancës së kaluar.

Me vota unanime (25) u miratua procesverbali i seancës së kaluar.

Pika e tretë: Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-strategjisë për Zhvillimit Ekonomik të Komunës 2017-2021.

Haxhi Ibishi, foli rreth Draft-strategjisë për Zhvillimit Ekonomik të Komunës 2017-2021. Në vijim kryesuesi Ibishi, shtoi se me iniciativën e kryetarit të Komunës, zotit Bashota, është formuar një trupë që ka punuar rreth kësaj draft-strategjie.

Kryesuesi Ibishi, fjalën e barti te drejtori i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, z. Ramiz Rrusta.

Ramiz Rrusta (drejtor i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, foli rreth Draft-strategjisë për Zhvillimit Ekonomik të Komunës 2017-2021. “Do të kishte qenë mirë që më hollësisht rreth hartimit të kësaj draft-strategjie të na flas ndonjëri prej pjesëmarrësve në hartimin e kësaj draft-strategjie që ka qenë në Durrës të na sqarojë.

Haxhi Ibishi, hapi debatin rreth kësaj draft-strategjie.

Fadil Gashi, theksoi se kemi pasur kërkesa në vazhdimësi për hartimin e kësaj strategjie. “Ky dokument i ka munguar Klinës prej 2010, dhe fillimisht po e them që është mirë që e kemi si dokument, pavarësisht se a ka hapësirë për të ndërhyrë apo nuk ka, megjithatë brumi është si bazë, edhe tash jam pak i hendikepuar për ta lavdëruar apo s’është për të lavdëruar. Kisha propozuar që faqja 2 të hiqet, te Hyrja e Kryetarit, sepse është dokument institucional, nuk është ndonjë elaborat, nuk është ndonjë buletin, me mirëkuptim po e them, sepse është sikur çdo dokument si çdo vendim që nxjerrim në këtë Kuvend. Edhe në KPF kam thënë, nëse ka ndryshime tregonani, neve nuk na është ardhur me ndryshime, unë ju përgëzoj po që se keni përmirësuar. Pikërisht këtë e kam kërkuar, nëse ka ndryshime të na njoftoni. Unë nuk e kam me përmirësime. Te pjesa e dytë, fq. 8, te buxheti i Komunës: në strategji është bërë ndarja buxhetore sipas viteve, unë pikërisht kam përcjellë edhe kornizën afatmesme buxhetore që e kemi në rend të ditës. Këtu është planifikuar buxheti sipas viteve, por e kam krahasuar me KAB

që kemi sot në rend dite edhe nuk kanë përputhshmëri. Këto dy dokumente duhet patjetër për t'u harmonizuar mes vete. Tash duhet përshtatur po që se duam ta miratojmë sot këtë strategji, Korniza afatmesme buxhetore pikë dhe presje duhet me qenë e harmonizuar me te. Në Kornizën Afatmesme Buxhetore është tjetër shifër, për vitin 2018, 9,431,000 euro, ndërsa në strategji 8 852 000 euro. Po ashtu ndryshon, te viti 2019, janë 10 95000 euro, ndërsa këtu janë 9 26000 euro. Do të thotë kemi të bëjmë me shifra. Është mirë për të pasur një harmonizim, sepse çdo dokument tjetër, jo vetëm në buxhet, por edhe planifikimet tjera që janë në këtë strategji duhet për t'u përmbajtur çdo iniciativë tjetër të Komunës, sepse kjo është baza më e fuqishme të zhvillimi ekonomik, sepse ne kemi planifikuar për këto vite të ardhshme. Është mirë për ta diskutuar edhe afatin e saj, a ka mundësi të zgjatet afati i kësaj strategjie për zhvillimin që planifikohet për të pasur Komuna e Klinës. Dhe shqetësim tjetër, përpos asaj që ka identifikuar grupi punues në këtë strategji është ajo që ne kemi përsëritur me parë, ata e kanë identifikuar si sfidë, edhe e kanë si objektiv, si synim, domethënë të dyja, se përmendet në tri raste, ku po shkelet destinomi i tokave bujqësore, që ka paraparë edhe si problematikë, edhe si sfidë, edhe si synim, edhe si objektiv të ardhmen. Do të kishte qenë mirë për të gjetur një konkludim, çka duhet. Ata po thonë se duhet për t'i ndërprerë, mirëpo ne jemi para një akti të kryer me një pjesë bukur të madhe se po që se tash miratojmë këtë strategji duhet për ta ditur se menjëherë qysh nesër jemi duke e shkelur, nesër jemi duke shkelur këtë strategji. Prandaj është mirë për ta pasur një trajtim të veçantë me një ndërhyrje të lehtë. Kjo nuk do ndërhyrje, por duhet planifikuar çfarë duhet të bëjmë, a duam për t'i legalizuar ato? Me filluar procedurën e legalizimit sipas ligjit për legalizim. Nuk mund të hysh edhe me rrënimë, është procedurë edhe kjo, prandaj duhet planifikuar se çka? Prandaj, pasi e kemi strategji na ndihmon edhe me marrë iniciativa për të pasur të drejtë të ai zhvillim. Te pjesët tjera, ku përmenden ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, fuqishëm jam pas kësaj çka planifikohet, do të kishte qenë mirë për ta parë edhe në të ardhmen a përcillen, se këto mbesin fjalë. Çka ne mundemi, është propozuar për të qenë një fond, e para, a kemi të drejtë, këtë duhet parë, a kemi të drejtë për ta pasur një fond për zhvillim për këto ndërmarrje, për te shoqatat e bizneseve apo çka janë ato, ato të gjitha mund të bëhen. Për ta pasur një fond tash për të ndihmuar zhvillimin ekonomik, qysh është tek ato ndërmarrjet e vogla e të mesme, qofshin ekonomi familjare, a kemi të drejt ta kemi atë fond. Fillimisht, duhet parë procedurën, pastaj të shikohet a ka mundësi për të iniciuar. Në këtë strategji kur t'i referohesh pastaj pjesës së fundit të projekteve, dominojnë asfaltimi i rrugëve, trotuareve, rinovimit të objekteve të shkollave, rrethojave, banjave nëpër shkolla, domethënë të zhvillimi i përgjithshëm, në pjesën e fundit po them. Janë disa penda, por çka bëhet për zhvillim të mirëfilltë të bujqësisë. Ne i kemi identifikuar cilat janë fushat, cila është toka që punohet në komunën e Klinës me hektarë krejt është e zbërthyer. Është mirë për t'i përcjellë me ndërhyrje konkrete që ne planifikojmë në të ardhmen duke respektuar këtë strategji, sepse në fund nuk e keni këtë ose te çështja e arsimit, me gjitha ato prioritete që janë nxjerrë diku 17-18 prioritete vetëm në një vend thuhet për disa trajnime të personelit. Shikoni, ne kemi nevojë për ta ngritur cilësinë, me shkuar paralel, sa të shkojnë ndërhyrjet në infrastrukturë duhet për të qenë edhe në cilësi të arsimit. Edhe the çështja tjetër, nëse i referohemi zonës së gurëve të mirë në Gllarevë, mos e lini anësh, sepse

gurë të mirë janë edhe në Sferkë. Te pasuritë nëntokësore që kemi, atje ishte përmendur vetëm Gllareva, por edhe Sferka është furnizues që njihet për gurin cilësor. Ose përmendet atje Gremniku, “Gremniku kanë mbjellë lakra”, pse a nuk mund të mbillen edhe specat, pse a nuk tëbëhen në Gremnik a? Janë disa gjera që duhet harmonizuar për t’i parë në kuptimin pak më të gjerë. Këto janë ato çështjet që mundet për të pasur një qasje më të drejtë. Edhe DF ka mundësi ose me një aneks, për të përcjellë në fushën e bujqësisë ose të zhvillimit ekonomik vijnë ndërmarjet e vogla dhe të mesme çka mund ne të bëjmë për t’i stimuluar ato. Më bëri përshtypje te shifrat e të punësuarve edhe të papunësuarve. Te shifra e të punësuarve kemi një shifër te agjencioni, edhe këtu një vërejtje, ku thuhet Enti Statistikor, enti ka qenë dikur, tash e kemi agjencion. Më nuk është ent, por agjencion, prandaj aty nuk po përputhen ato të dhëna. Nëse marrim numrin e përgjithshëm të bizneseve që zhvillojë veprimtarinë e vet, po dalin diku 2900 biznese, nga 1 punëtorë janë 2900 herë 2 po bien gati te 6000, ndërsa këtu kemi 4800-4900 të punësuar. Kjo shifër ndoshta është gabim teknik, është mirë të shikohen edhe një herë shifrat, sepse kur të miratohet, është dokument zyrtar nuk mundesh pastaj për të ndërhyrë. Përndryshe, pjesa tjetër është e pranueshme, edhe pse jemi vonuar, megjithatë mirë që e kemi sot”, ka konstatuar anëtari Gashi.

Sokol Bashota, tha se kam përshtypjen që jemi duke folur për dy dokumente që po na ngatërrohen. Të dyja janë si pika të veçanta të rendit të ditës, është edhe shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës dhe Draft-strategjia për Zhvillim. Për Kornizën nuk kemi qenë në Durrës. Unë mendoj ndoshta nuk është vonë për t’u harmonizuar në këtë Strategji të Zhvillimit. Nëse kjo është në shpërputhje atëherë bien ndesh dy dokumente që nxirren nga kjo asamble. Te implikimet buxhetore, nëse janë të harmonizuara në rregull. Ta dimë se kjo ka për t’u votuar përpara e ta dimë që kjo duhet për të qenë e harmonizuar me strategji”, theksoi kryetari Bashota.

Tunë Dedaj, tha se kam qenë në atë grup punues, kisha falënderuar grupin punues ka punuar më përkushtim të madh, ka qenë grup i ekspertëve. “Mbasi ne si grup i anëtarëve të AAK-së nuk e kemi marrë materialin, kisha propozuar që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e radhës të AK-së. Materialin e përmirësuar nuk e kemi marrë”, theksoi anëtari Dedaj.

Rasim Millaku, tha se ne kemi pranuar një strategji e cila është vu në diskutim publik dhe pas diskutimit publik besoj se është dashur të kishte pasur ndryshime, mirëpo nuk e kemi. “Nëse duam për ta miratuar një strategji pa ndryshime, pse është bërë diskutimi publik. Disa projekte që asambleja, përkatësisht ky komision është dashur të marr parasysh propozimet nga BL që unë vi, unë kam potencuar disa projekte, qoftë minore apo qoftë madhore asnjëra prej tyre nuk është e inkorporuar. Unë prapë më duhet potencuar që në shkollën fillore të Ujmirit janë paraparë plot investime më herët, për t’u ndërtuar edhe shkolla e re, më 2018, qoftë në ndonjë vit vijues, pastaj për të bërë investime për nxehje, dyer dhe dritare. Edhe kam përmendur QMF, janë përmendur dy ura, një investim i vogël, dhe nuk janë përfshirë në këtë strategji. Nuk di se ky komision a i ka dëgjuar këto propozime tona, për të mos u ndalur edhe në projekte tjera, asfaltimin. Në BL të Ujmirit është lënë anësh dhe është futur vetëm kanalizimi, ujësjellësi në Çabiq për vitin 2018, tjetër nuk ka asnjë ndryshim nga diskutimet tona që i kemi pasur në këtë AK. Ju kisha lutur këtë

komision, sepse vij nga një zonë ku ka nevojë, të merren parasysh edhe diskutimet tona jo vetëm qysh ata mendojnë”, ka konstatuar anëtari Millaku.

Haxhi Ibishi, tha se kjo është strategji zhvillimor, makro ku synohet për 4 vite apo 5 vite të arrijmë zhvillimin ekonomik të Klinës. “Në ato pika janë dhënë resurset ekonomike, resurset njerëzore, burimet e mundshme financiare, edhe në lëmenjtë të caktuar. Fadili e tha që është mirë për t’u harmonizuar”, tha kryesuesi.

Bedri Gashi, drejtor i Shëndetësisë dhe i Mirëqenies Sociale, theksoi QMF në Ujmir është futur në prioritet për sivjet, nuk ka pasur nevojë që të futet edhe në strategji. “Rinovimi i saj do të kryhet sivjet, edhe çështje e ujit, edhe çështja e një asfalti rreth 100 metra deri aty besoj që do të përfundojnë brenda këtij viti” ka pohuar drejtori Gashi.

Xufë Kelmendi, zyrtare e lartë e DF raportoi në mënyrë kronologjike rreth çështjes së Draft-Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik 2017-2021. “Unë nuk di që në këtë strategji Çka është e paharmonizuar, kisha dashur të di se çka nuk është e harmonizuar brenda kësaj draft-strategjie. Unë e di se çështjet janë të harmonizuara në këtë draft-strategji”, sqaroi zyrtarja Kelmendi, e cila në vijim po ashtu sqaroi shumë gjer rreth këtyre çështjeve në shqyrtim dhe diskutim.

Haxhi Ibishi, theksoi se këtë strategji e kemi pasur dhe e kemi shqyrtuar edhe në KPF. “Propozimet që i keni ju, kjo asamble është që i heq apo i fut, apo edhe ndonjë propozim që ka ndonjë këshilltar.

Ndue Shabanaj, tha se mendoj që kjo strategji është shumë e mirëseardhur, nuk ka nevojë të konstatohet mungesa e saj, sepse e dimë të gjithë. Është mirë që e kemi përpara dhe kemi mundësinë për ta aprovuar në këtë AK këtë strategji, por për ta pasur edhe në të ardhmen, për të qenë bazë e zhvillimit ekonomik të Komunës për periudhën e ardhshme. Unë mendoj që këta që kanë marrë pjesë në hartimin e kësaj strategjie kanë dhënë kontributin e tyre. Si material mua po mëpëlqen, ka shumëçka që është më të vërtetë e nivelit të duhur dhe më të vërtetë që ia vlen për ta pasur Komuna një strategji të tillë, por kjo nuk do të thotë që nuk ka edhe mangësi. Për mendimin tim vështirësi fillestare është se nuk është raportuar këtu nga ekzekutivi, për t’u shkoqitur kjo në mënyrë të gjithanshme, jo vetëm si formë e shkruar kështu, por edhe pjesa e raportit që bën ekzekutivi para AK para miratimit të këtij dokumenti që vërtet është i një rëndësie të veçantë. Unë dua të ndalem te një pjesë thuhet se mund të mos jetë e përfshirë në këtë strategji, një proces i zhvillimit, ose një projekt i veçantë, por të realizohet ose të ndodh e kundërta, të jetë këtu por të mos realizohet. Mendoj që strategjia duhet të përfshijë në mënyrë të gjithanshme zhvillimin ekonomik të Komunës së Klinës për periudhën e ardhshme. Mund të mos ketë përfshirë diçka që mund të jetë produkt i ardhmërisë që nuk kemi mundur për ta paramenduar, nuk kemi mundur për ta paralogarit, se vërtet për shumëçka duhet pasur paralograinë. Kur është fjala këtu, fq. 44, ku janë projektet e veçanta, e kanë të bëjnë me investimet kapitale, projektet që synohen të realizohen gjatë periudhës 2017-2021, është mirë të jetë më gjithëpërfshirës, kjo [pjesë e këtyre projekteve. Pajtohem me parafolësit që zona të

caktuara nuk janë përfshirë fare, dhe ka fshat që jo që nuk është investuar për 17 vite deri me sot, por nuk përfshihet fare as në këtë strategji për periudhën pesëvjeçare. Unë kam bërë thirrje dhe prapë do ta përsëris, është mirë për ta pasur një pasqyrë të përgjithshme ekzekutivi dhe për ta ditur ku janë ato fshatra dhe pse është gjendja ashtu dhe prapë deri më 21 nuk janë të përfshira në realizim të projekteve. Nuk po flas për projekte të veçanta përkatësisht fshatrat të veçantë, por unë po them se kjo është strategji e përgjithshme e zhvillimit të Komunës së Klinës dhe duhet për t'i pasur të gjitha vendbanimet, lokalitetet, fshatrat dhe të pasqyrohen ato çka planifikohet të investohet”, ka nënvizuar prof. Shabanaj.

Fadil Gashi, tha se brumi është i mirë, dikush e ka materialin, dikush nuk e ka. “Ne materialin e kemi kërkuar me ndryshimet, por nuk na ka mbërritur. Ne kemi kërkuar për të na njoftuar me ndryshimet, por nuk na keni njoftuar, nuk po i dimë përmirësimet. Nuk është kontestuese buxheti, mirëpo e pashë që buxheti në këto dy dokumente po ndryshon. Është mirë nëse ndryshon buxheti për mirë. Ne jemi duke biseduar për një dokument që ka vizion. A kemi të drejtë për të krijuar një fond për zhvillimin ekonomik të Komunës. Unë nuk po them pse e keni ose pse e kanë propozuar, por po pyes vetëm se a kemi të drejtë për të krijuar fond”, theksoi ndër të tjera anëtari Gashi.

Pjetër Coli, theksoi se më duket që kjo kornizë afatmesme është e mirë, mirëpo prioritetet nuk më pëlqyen, prandaj prioritetet unë i kisha bërë ndryshe. “Prioriteti numër një për mua sidomos këtyre ditëve vape gjatë lëvizjeve që i kam bërë më ka rënë në hundë kundërmimi në fshatra ku mungon kanalizimi, edhe mua më duket se këtu është një prioritet shumë i madh që të punojmë në këtë drejtim dhe t'u japim prioritet kanalizim, sepse është preventivë e banorëve tanë dhe kisha bërë apel shumë serioz që kanalizimet të merren si prioritet i parë dhe të tjerat me radhë”, ka shtuar anëtari Coli.

Sokol Bashota, theksoi se në këtë strategji janë të paraparë mbi 50 për qind të kanalizimeve nëpër fshatra dhe lokalitete të komunës sonë. “Ka projekt që nuk varet nga ne, realizimi i tij nuk është në domenin tonë. Donatorët kërkojnë për cilindo projekt a është në strategjinë e zhvillimit ekonomik të Komunës. Asnjë projekt që nuk është në strategji nuk financohet nga asnjë donatorë. Unë falënderoj komisionin për punën që ka bërë. Është bërë një punë shume e mirë, meqenëse nuk mund të thuhet që nuk ka hapësirë për plotësime. Si dokument ia vlen edhe Asamblesë Komunale, edhe ekzekutivit, i cili ia vlen që të respektohet”, ka shtuar kryetari Bashota.

Tunë Dedaj, theksoi që strategjia është devijuar. “Kanë qenë të paraparë edhe disa projekte të tjera, që nuk po i vërej. Ka qenë i paraparë kanalizimi për Zajm, Dugajevë, Deiq, Videjë, që të gjitha janë hequr. Kush i ka hequr nuk e di. Kanalizimet në zonat rrafshinore duhet për të qenë në prioritet, ndërsa në zonat kodrinore duhet si prioritet për të qenë sigurimi i ujët të pijshëm”, ka pohuar anëtari Dedaj.

Fadil Gashi, theksoi se kur të na vjen buxheti, atëherë flasim.

Skënder Merturi, tha se le të punohet edhe një kohë, të bëhet harmonizimi, atëherë ta votojmë, nuk është harmonizimi”, pohoi anëtari Merturi.

Enver Marmullaku (drejtor i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural), kërkoi që brenda strategjisë të futet riparimi i pendëve të ujitjes.

Pjetër Coli, kërkoi që të futen ato vendbanime që ka paraparë komisioni, pastaj le të votohet.

Xufe Kelmendi, kërkoi që anëtarët të përgatisin një regjistër të projekteve, të cilat do të inkorporohen në strategji

Tunë Dedaj, theksoi që strategjinë mund ta aprovojmë, mirëpo propozimet e bëra të vihen në strategji.

Ndue Shabanaj, theksoi se strategjia nuk mund t’i parashoh të gjitha projektet, por kur disa janë përfshirë, ndërsa disa jo, jep mundësi për dyshimin e krijimit të laraminive. Jam për ta miratuar, mirëpo çështja e projekteve nuk është e paraparë si duhet.

Haxhi Ibishi, kërkoi që të aprovohet strategjia me këto plotësime që u bënë nga ana e anëtarëve të Kuvendit.

Pjetër Coli, theksoi se propozimi i Xufës është i pranueshëm, të përgatitet një listë e projekteve të propozuara.

Ndue Shabanaj, theksoi që është mirë të miratohen edhe këto propozimet e bëra.

Xufe Kelmendi, sqaroi çështjet e ngritura nga anëtarët. “këtu në strategji janë projektet 2017-2020.

Sokol Bashota, theksoi që projektet duhet përfshirë në strategjinë zhvillimore, propozimet të bëhen këtu.

Ndue Shabanaj, tha se ka fshatra që për 18 vjet nuk është investuar asgjë. “Fshati Ranoc s’ka përfituar asnjë investim, po ashtu Leskoci, Pataqani, Radulloci, lagja e Duhanëve, që duhet të përfshihen. Krusheva e Madhe ka dy lagje, lagja Palushaj nuk është investuar asgjë për kaq vite. Gjithmonë kam kërkuar për një balancim të zhvillimit të Komunës”, ka theksuar prof. Shabanaj.

Esa tRaci, kërkoi që në strategji të përfshihen fshatrat që s’kanë kanalizim.

Tunë Dedaj, theksoi se të gjitha fshatrat që i potencova më lart kanë qenë të propozuara, mirëpo janë hequr.

Petrit Palushi, theksoi se që 18 vjet në lagjen Palushaj nuk është investuar përpos tre kamionëve zhavorr. “Propozoj që të futet asfaltimi i rrugës, po ashtu edhe kanalizimi”, tha anëtari Palushi.

Fadil Gashi, theksoi se kemi rrëshqitur prej dokumentit. “Nuk është projekt-buxhet, fjala është për strategjinë e zhvillimit komunal. Strategjia është mirë për të pasur debat në Kuvend për zhvillimin ekonomik, si të krijohen kushtet për të rritur këtë zhvillim ekonomik. S’jemi duke bërë asnjë fjalë për strategjinë e zhvillimit”, ka pohuar anëtari Gashi.

Sokol Bashota, theksoi që komisionit i kemi kërkuar të bëhet kjo strategji në mënyrë që të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik të Komunës. Ky është brumi, të jeni të sigurt se do të implementohen edhe më shumë projekte që janë këtu.

TunëDedaj, theksoi që të futen propozimet dhe të procedohet për miratim.

Kryesuesi vuri në miratim Draft-strategjinë e Zhvillimit Ekonomik të Komunës 2017-2021, me plotësimet.

Me 23 vota për, 1 abstenim u miratua me plotësime Draft-strategjia e Zhvillimit Ekonomik të Komunës 2017-2021.

Pika e katërt: Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore – KAB- periudha 2018-2020.

Kryesuesi foli rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore – KBQ periudha 2018-2020. Fjalën e barti të drejtori i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, z. Ramiz Rrusta.

Ramiz Rrusta, drejtor për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, në mënyrë kronologjike raportoi rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore – KBQ periudha 2018-2020.

“Kemi mbajtur disa takime në Zllakuqan, nesër do të mbajmë në Ujmir. Qëllimi është që të bisedohet me komunitetin në mënyrë që të njihemi me kërkesat e tyre dhe të vlerësojmë çka mund të përfshihet në kornizën afatmesme buxhetor 2018-2010. Jemi me kohën. Mbështetemi në Qarkoren e Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës”, pohoi drejtori Rrusta, i cili në vijim sqaroi edhe disa çështje rreth kornizës afatmesme buxhetore.

Skënder Merturi, theksoi se te faqe 20 i pashë projektet e propozuara në këtë kornizë afatmesme. “Propozoj përmirësimin e varrezave të dëshmorëve, të bëhet një riparim. Varrezat e dëshmorëve janë në gjendje tepër të keqe, prandaj duhet sanuar gjendjen e tyre atje, pra të bëhet riparimi i tyre. A është menduar rregullimi i kanalizimit në Sferkë? Fajin për gjendjen e atij kanalizimi e bart ekzekutivi e jo qytetarët. Te kanalizimi në Gjurgjevik të Madh, nga avaria e atij kanalizimi e shkollës pinë ujë të ndotur që ju paraqitet rreziku për ndonjë epidemi”, theksoi anëtari Merturi.

TunëDedaj, theksoi se është dashur që të konsultohen grupet parlamentare.

Enver Gashi, theksoi se megjithëse janë përfshirë në bashkësinë lokale te Sferkës disa projekte kapitale e te planifikuara te korniza afatmesme buxhetore 2018- 2020, shprehi shqetësimin e bashkësisë lokale te Sferkës lidhur me shumë shqetësime e në veçanti dua te ndalem rreth dy

problemeve: 1. Problemi i ujësjellësit dhe 2. Problemi i ujërave te zeza. Edhe pse bashkësia lokale e Sferkës e kemi rrjetin e ujësjellësit, banorët e bashkësisë lokale janë duke vuajtur për ujë. Që pesë vite ujësjellësi nuk është funksional. Si përfaqësues i asaj zone çdo ditë nga shqetësimet e banorëve kemi shumë ankesa, telefonata, kontakte, ku qytetarët shprehin shqetësimin e tyre, duke u ndier te zhgënjyer, te nënçmuar te lenë pas dore nga pushteti aktual. Qytetarët janë ne hall shumë te madh rreth ujit te pijes e sidomos tash në stinën e verës, ku është vapë shumë e madhe dhe janë temperaturat shumë te larta. Është për të ardhur shumë keq ku banoret e bashkësisë lokale nuk kanë ujë, janë te detyruar me automjete, traktorë, duke i mbushur shishet, cisternat ne një krua në hyrje te fshatit (Vrell) duke pritur me orë të tëra për ta dërguar ujin ne familjet e tyre. Kjo gjendje e mjeruar e bashkëvendësve te mi lenë te kuptohet apo mos vallë janë duke jetuar këta banorë ne Kalkutë apo diku ne shkretëtire. Po ashtu edhe projekti i ujërave te zeza kërkon një ndërhyrje sa me te shpejtë sepse është gjendja alarmante. Ne fshatin Perqevë nuk është funksional kanalizimi. Ne fshatin Qypevë te lartë nuk është funksional kanalizimi. Ne fshatin Volljakë ne disa lagje nuk ka kanalizim, ne disa lagje gypat janë bllokuar, kanalizimi ne disa lagje derdhet afër banoreve, ku ndihet një kundërmim shumë i rendë, e si rast i veçante pa dyshim është lagjia e Bilallëve ku krejtësisht është lënë pas dore nga pushteti ku mbas lufte qe 18 vite nuk është investuar asnjë projekt. Ne fshatin Dush nuk ka kanalizim. Ne fshatin Sferkë ne lagjet e Marinve, Kuburve gjendja është shumë e rendë, fare nuk ka kanalizim, ndërsa ne disa lagje edhe pse janë gypat gjendja është alarmante, ku gypat janë te bllokuar qe një kohë te gjatë, e ne veçanti dua të përmendi një rast, afër shtëpisë se Bislim Gashit, i cili është veteran i UÇK- së , i dënuar politik, veteranë i arsimit, gypat e kanalizimit janë bllokuar, ujërat fekale kanë shpërthyer është shumë rrezik i madh për përhapjen e ndonjë epidemie jo vetëm për atë familje por për krejt banorët e lagjes se Balajve. Andaj apeloj qe sa me parë drejtoritë përkatëse ne bashkëpunim me kompaninë Hidrodrini t'i zgjedhin këto shqetësime te banorëve sa nuk është bërë vonë se me te drejtë qytetarët pyesin deri kur kështu !”, ka konstatuar anëtari Gashi.

Ramush Agushi, foli rreth prioriteteve të bashkësisë lokale të Drenocit. Anëtari Agushi theksoi se bashkësia lokale e Drenocit ka disa prioritete që duhet të përfshihen brenda strategjisë. “Kërkoj që këto probleme me të cilat ballafaqohen banorëve e këtyre lokaliteteve të kësaj bashkësia lokale të rregullohen. Kisha kërkuar që në prioritet për vitin 2018 të përfshihet rruga e fshatit Poterq, po ashtu edhe fshati Dugajevë nuk ka kanalizim, çështja e një rruge lokale të fshatit Drenoc e cila ka nevojë që të rregullohet, u prezantua edhe dje në debatin me qytetarë” është shprehur anë tari Agushi.

Qamile Qitaku, prezantoi sërë projektesh me interes për qytetarët. Anëtarja Qitaku theksoi që në strategjinë zhvillimore nuk janë përfshirë disa kategori. “Për shembull: kujdesi për nënën dhe fëmijët, hapësirat e gjelbra, hapësira për lojëra për fëmijët, kategoria e të moshuarve janë pa përkujdesje. Unë disa herë e kam ngritur si prioritet çështjen e ndërtimit të një shtëpie për pleqtë. Ka vend edhe për projekte për barazi gjinore”, është shprehur anëtarja Qitaku.

Ndue Shabanaj, theksoi se dëshiroj që disa projekte që ishin në prioritet në afat më të gjatë të përfshihen në afat më të shkurtër. “Fshatrat që s’kanë pefituar të jenë në prioritet. Projektet që

janë jashtë funksionit, për të cilat është investuar, të bëhen përpjekjet të funksionalizohen. Po ashtu aty ku ka pengesa nga ana e banorëve të caktuar që pengojnë realizimin e ndonjë projekti, pushteti ta ushtron ndikimin. Kërkesa ime te brigjet e të njëjtit lumë të jenë të njëjtë. Është e pajustificueshme që dy brigjet e të njëjtit lumë të jenë të dalluar. Në njëërën anë të bregut të këtij lumi bëhet rregullimi, ndërsa në anën tjetër nuk rregullohet. Rasti konkret lidhet pjesën kah lagja e Palucajve nuk bëhet rregullimi i lumit, ndërsa në pjesën tjetër bëhet. Kjo nuk është në rregull”, ka theksuar ndër të tjera prof. Shabanaj.

Pjetër Coli, theksoi se asfaltimi i rrugës në Krushevë e Madhe, do të kishte qenë mirë që të lidhen dy asfalte, mirëpo ky projekt të trajtohet si i njëjtë. “Nëse nuk ka buxhet le të shtyhet në mënyrë që të asfaltohet si i tërë”, shtoi anëtari Coli.

Petrît Palushi, foli rreth çështjes në debat. Anëtari Palushi, theksoi që ajo rrugë të kryhet ashtu siç thotë baca Pjetër, kjo rrugë të futet në vitin 2018.

Tunë Dedaj, sqaroi rrugët e prezantuara nga anëtarët Coli dhe Palushi.

Ndue Shabanaj, theksoi që kanalizimi në Kërnice është shënuar dy herë.

Fadil Gashi, theksoi se fq. 1, vërejtje, duhet hequr 2016, duhet të jetë 2017, është bërë copy paste, po ashtu duhet hequr shifrën prej 100 mijë euro, figuron dy herë.

Skënder Merturi, theksoi se a po hynë prioritetet e mia në mënyrë që të di qysh te votoj.

Baki Gashi, drejtor i Urbanizmit dhe Çështjes së Mjedisit, foli rreth çështjes së kanalizimit në Sferkë dhe ujësjellësit, po ashtu sqaroi edhe shumë çështje të tjera që kanë të bëjnë me infrastrukturën e disa lokaliteteve. Drejtori Gashi, sqaroi edhe çështjen e rregullimit të brigjeve të lumit Klina.

Ndue Shabanaj, theksoi se e di që ana e majtë deri në fund trotuari është i rregulluar, ndërkaq pjesa tjetër kah lagja Palucaj prej fillimit deri në fund nuk është e rregulluar. E vërteta e këtij rasti qëndron kështu. Të formohet një komision dhe të shkojmë në vend në mënyrë që ta konstatojmë të vërtetën. Shqetësimi im është i bazuar në fakte”, shtoi prof. Shabanaj.

Skënder Merturi, tha se nuk pajtohem me drejtorin që thotë “propagandë”. “Propagandë nuk është gjendja e varrezave të dëshmorëve, të shkojmë dhe të bindemi në çfarë gjendje janë varrezat e dëshmorëve. Nxënësit e Gjurgjevikut të Madh të cilët pinë ujë të ndotur nuk është propagandë”, theksoi anëtari Merturi.

Enver Gashi, problemi i kanalizimit është problem në lagjen time, ka kundërmim të padurueshëm. “Deri kur për të pritur?! Unë po ballafaqohem me qytetarët”, shtoi anëtari Gashi.

Haxhi Ibishi, theksoi se debati zhvillohet në aspektin e përgjithshëm dhe jo në atë personal.

Sokol Bashota, foli rreth disa çështjeve të ngritura nga anëtarët. “I pranoj të gjitha vërejtjet. Teknikisht në Sferkë është bërë pranimi. Kanalizimet nuk i menaxhon Komuna e Klinës. Ne kemi investuar shumë për kanalizimet. Hidrodrini merr përsipër mirëmbajtjen. Ai gjeneron të hyra, jo ne. Në shumë fshatra as që tatimohet. Duke punuar nëpër fshatra në mënyrë që të krijohet kultura e të tatimuarit. Ndikoni në vendbanimet nga vini për t’i paguar taksat. E kuptoj si shqetësim”, ka shtuar ndër të tjera kryetari Bashota.

Pjetër Coli, theksoi që Hidrodrini është ndërmarrje e dështuar.

Kryesuesi vuri në miratim Kornizën Afatmesme Buxhetore 2018-2010.

Me 23 vota për 1 abstenim u miratuar KAB 2018-2010.

Pika e pestë: Shqyrtimi i Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Klinës 2017.

Kryesuesi foli rreth Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Klinës 2017.

Hapi debatin. Nuk pati debate.

Kryesuesi vuri në miratim Planin e Veprimit për Transparencë në Komunën e Klinës 2017.

Me vota unanime (24), u miratua Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Klinës 2017.

Pika e gjashtë: Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për vënie në diskutim publik të Projekt-rregullores për Pronën e Paluajtshme.

Kryesuesi foli rreth çështjes në rend të ditës. Hapi debatin. Nuk pati debate. Kryesuesi kërkoi miratimin e Propozim-vendimit për vënie në diskutim publik të Projekt-rregullores për Pronën e Paluajtshme.

Me vota unanime u miratua propozimi-vendimi.

Pika e shtatë: Raportimi i Kryetarit për situatën ekonomiko-financiare të Komunës dhe zbatimit i planeve investuese të Komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2017.

Kryesuesi fjalën e barti te Kryetari i Komunës së Klinës, Sokol Bashota.

Sokol Bashota, raportoi rreth raportit të periudhës së parë 6-mujore të vitit 2017.

“Të nderuar anëtarë të AK, po e paraqes para jush Raportin 6 mujor të punës së ekzekutivit komunal në të cilin janë përfshirë shumë projekte të realizuara në fusha të ndryshme. Pushteti lokal në Klinë gjatë kësaj periudhe 6 mujore të këtij viti janar-qershor 2017 vazhdon të mbetet i përkushtuar në përmirësimin e mëtejshëm të ofrimit të shërbimeve në të gjitha fushat e jetës. Arritjet tona janë të përbashkëta me qytetarët tanë dhe institucionet tona. Fokus të veçante i kemi dhënë arsimit, shëndetësisë, bujqësisë, infrastrukturës në përgjithësi, por edhe gjithë resorëve

tjerë, duke spikatur angazhimin konkret për një jetë më të mirë të qytetarëve, për shëndetin, për arsimim të gjeneratave të reja, për një të ardhme në agrokulturë dhe agrobiznes, por edhe për angazhim në kuadër të përmirësimit të imazhit të Klinës edhe në aspektin e mirëqenies dhe përkujdesjes për familjet të cilat janë në gjendje të vështire ekonomike dhe kanë probleme shëndetësore. Si rezultatet e qeverisjes së mirë gjatë kësaj periudhe janë realizuar dhe janë në procesin e realizimit e kontraktimit mbi 30 projekte, ka shtuar kryetari Bashota, i cili në vijim foli edhe për të arriturat në shumë fusha të jetës, si në arsim, administratë, bujqësi, shërbime publike, kulturë etj. Duke folur për Të hyrat dhe shpenzimet, kryetari Bashota theksoi se në linjë me qëllimet dhe premtimet tona, ne kemi ulur ne vazhdimësi shpenzimet komunale – p.sh. shpenzimet për derivate janë ulur në krahasim me vitin paraprak, kurse të hyrat kanë shënuar rritje. Kemi edhe rritje të mjeteve për investime kapitale. “Jemi angazhuar fuqishëm që të arrijmë nivelin më të lartë të transparencës komunale dhe në vazhdimësi jemi kujdesur që praktikat më të avancuara demokratike, të aplikohen gjatë vendimmarrjes në qeverinë komunale. Si ekzekutiv jemi treguar mjaft koshient dhe kemi arritur të marrim donacione të shumta nga niveli qendror i qeverisjes nëpër ministri përkatëse për të realizuar projekte për mirëqenie të qytetarëve. Do vazhdojmë edhe në të ardhmen të realizojmë objektivat tona të cilat janë përtej planifikimeve vjetore dhe kjo falë një qeverisje të mirë të pushtetit lokal”. Kryetari i Komunës së Klinës, Sokol Bashota, gjatë prezantimit të raportit ekonomik financiar dhe investimeve në periudhën janar-qershor 2017, para anëtareve të Kuvendit të Komunës së Klinës, ka thënë se pushteti lokal në Klinë gjatë kësaj periudhe vazhdon të mbetet i përkushtuar në përmirësimin e mëtejshëm të ofrimit të shërbimeve në të gjitha fushat e jetës. “Arritjet tona janë të përbashkëta me qytetarët tanë dhe institucionet tona”. Sipas tij, fokus të veçantë i është dhënë arsimit, shëndetësisë, bujqësisë, infrastrukturës në përgjithësi, por edhe gjithë resorëve tjerë, duke spikatur angazhimin konkret për një jetë më të mirë të qytetarëve, për shëndetin, për arsimim të gjeneratave të reja, për një të ardhme në agrokulturë dhe agrobiznes, por edhe për angazhim në kuadër të përmirësimit të imazhit të Klinës edhe në aspektin e mirëqenies dhe përkujdesjes për familjet të cilat janë në gjendje të vështire ekonomike dhe kanë probleme shëndetësore. “Si rezultatet e qeverisjes së mirë gjatë kësaj periudhe janë realizuar dhe janë në procesin e realizimit e kontraktimit mbi 30 projekte, siç janë ato të asfaltimit të rrugëve në Jashanicë, Këpuz-Qeskovë, Shtupel, Stupë-Zajm, Deiq dhe në qytetin e Klinës. Është duke u punuar në rehabilitimin e shtratit të Lumit Drini Bardhë ndërsa po rregullohen edhe kanalizime në Jashanicë, Gjurgjevik të Vogël dhe Caravik si dhe projekte tjera që ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e qytetarit. Një projekt tjetër kapital është fillimi i punimeve në ndërtimin e Qendrës Rinore që ka kushtuar 250 mijë euro”. Bashota, shprehet se prioritet të madh i kanë dhënë edhe arsimit duke investuar në hapësira të reja shkollore si dhe kemi arritur që bashkë me donator të realizojmë disa projekte që kanë ndikuar në ngritjen e kapaciteteve në arsim. “Gjatë këtij gjashtëmujori, kemi përfunduar tre objekte të reja shkollore moderne në Jashanicë, Perqevë dhe Këpuz, të cilat kanë qenë më se të nevojshme të cilat kanë kushtuar afër 1 milion euro. Do të ndërtohet edhe objekti i ri i shkollës “Ismet Rraci” në Klinë. Këtë periudhe 6- mujore komuna e Klinës nga buxheti komunal në

objektet shkollore ka investuar gjithsej 62 mijë e 270 euro dhe atë në dhe ka ndarë 20 bursa për studente nga 500 euro për person, gjithsej vlera 10 mijë euro. Po ashtu në këtë periudhë Komuna e Klinës, falë nja politike të mirë ka realizuar edhe projekte të shumta në bashkëpunim me donatorë ku është investuar në objektet shkollore, 100 mijë 723 euro. Kemi ndërtuar një administratë të qëndrueshme, efikase dhe të përgjegjshme, e cila po i përgjigjet kërkesave të qytetarëve dhe është duke ofruar shërbime me standarde profesionale. Të gjitha kërkesat procedohen me shpejtësi dhe kujdes të veçantë. Në aspektin e ofrimit të shërbimeve administrative për qytetarët, Komuna e Klinës ka shënuar progres përmes funksionalizimit dhe përdorimit të E-Kioskut, ku qytetarët mund të pajisen me 5 lloj të dokumenteve civile 24 orë. Përveç kësaj është në proces edhe riparimi i Zyrës së Gjendjes Civile në fshatin Gllarevë për të krijuar kushte sa më të mira për qytetarët”, njofton Bashota. “Bujqësia mbetet njëra ndër prioritetet e qeverisë lokale duke pasur parasysh se Klina ka një potencial të mirë për zhvillimin e bujqësisë për shkak të tokës pjellore. Në sektorin e bujqësisë prioriteti është dhënë ndërtimit të kanalit të ujitjes gjë që ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e kapaciteteve bujqësore. Kështu është në ndërtim kanali ujitjes Zllakuqan-Radulloç 1016 metra që ka kushtuar 27 448 euro, ku do të ujitën mbi 100 hektarë tokë me mundësi vazhdimi të këtij projekti nga i cili do të ujiteshin mbi 250 hektarë tokë të kësaj ane. Kemi edhe ndërtimin e kanalit të ujitjes në Grabanicë (Të penda e Ukë Sahitve) ku do të ujitën 100 hektarë tokë. Ky projekt është në realizim dhe ka kushtuar 29 317 euro. Në bashkëfinancim me Ministrinë e Bujqësisë është në përfundim e sipër projekti i ndërtimit të kanalit të ujitjes i gjatë 4250 metra Stupë-Budisalc- Krushevë e Madhe, ku do të ujitën mbi 300 hektarë tokë. Planifikohet edhe ndërtimi i kanalit të ujitjes në Dellovë i gjatë 1300 metra. Sa i përket Shërbimeve Publike, gjatë kësaj periudhe janë arritur rezultate të mira sidomos në krijimin e një ambienti sa më të pastër. Është bërë heqja e deponive ilegale në zonat rurale në 47 pika të Komunës së Klinës, projekt ky i cili ka kushtuar 16 840 euro. Në shëndetësi Klina, ka fituar një grant nga Qeveria e Japonisë në vlerë prej 68,220, kurse granti tjetër është siguruar nga Ministria e Shëndetësisë në emër të zbatimit të të drejtave të garantuara të komuniteteve RAE në Komunë e Klinës në vlerë prej 10.000 €. Gjithashtu, janë kryer të gjitha procedurat dhe jemi në proces të pritjes për marrjen edhe të një autoambulance tjetër nga Ministria e Shëndetësisë në vlerë prej 70.000 €. Pra, shuma totale e granteve të përfituar (përfshirë edhe autoambulancën e MSH-së që do të na vije arrin në: 142.220 €. Në investimet kapitale janë paraparë edhe rinovimi dhe sigurimi i aparaturave për Shërbimin e Urgjencës në QKMF-në “Nënë Tereza” në Klinë, rinovimet e QMF-ve në Ujmirë, Zllakuqan dhe Sferkë dhe 4 AMF-ve. Sa i përket të hyrave dhe shpenzimeve, të hyrat kanë shënuar rritje ndërsa janë zvogëluar shpenzimet për derivate. Jemi angazhuar fuqishëm që të arrijmë nivelin më të lartë të transparencës komunale dhe në vazhdimësi jemi kujdesur që praktikat më të avancuara demokratike, të aplikohen gjatë vendimmarrjes në qeverinë komunale. Do vazhdojmë edhe në të ardhmen të realizojmë objektivat tona të cilat janë përtej planifikimeve vjetore dhe kjo falë një qeverisje të mirë të pushtetit lokal”, ka konstatuar kryetari Bashota.

Kryesuesi Dr. Ibishi, falënderoi kryetarin Bashota për këtë prezantim dinjitoz.

Pika e tetë: Të ndryshme: Informatë rreth zgjedhjes së Këshillave të fshatrave dhe procedurave gjegjëse.

Haxhi Ibishi, foli rreth çështjes së ngritur të zgjedhjes së këshillave të fshatrave. “Dëshiroj t’i jap dy sqarime: Takimet i kemi zhvilluar në zyrën time. Jam informuar nga OJQ “Koha që kanë fituar një donacion nga MPL për zgjedhjen e këshillave për katër fshatra të Komunës sonë. Kanë bërë një plan. Ky komision në përbërje të zvogëluar kanë bërë një zgjedhje me procesverbal”, ka sqaruar kryesuesi Ibishi, i cili në vijim ka sqaruar edhe disa çështje të tjera që kanë të bëjnë me këtë projekt.

Ramush Agushi, në cilësinë e anëtarit të Komisionit, pohon realizimi i këtij projekti ka ngecur për shkak të mungesës së fondeve. “Komisioni është i gatshëm të procedojë me angazhimin dhe të kryejë këtë projekt. Kuvendi merr vendime, prandaj nuk përzihem në çështje të Kuvendit të Komunës”, ka theksuar anëtari Agushi.

Sokol Bashota, theksoi që iniciativat që vinë si të tilla janë iniciativa të ngutshme. “Komisioni i zgjedhur nga AK të kryejë punën e vetë, në mënyrë që t’i krijohen kushtet këtij komisioni për punë. Të diskutohet qysh të dilet dhe të kryhet si punë. Pa Komunën nuk mendoj që mund të jetë funksional. OJQ “Koha” është pjesë e këtij komisioni. Është mirë që të ulemi në mënyrë që të diskutojmë dhe të procedojmë”, theksoi kryetari Bashota.

Tunë Dedaj, theksoi që po flas në emër të grupit të anëtarëve të AAK-së. “Kemi formuar komisionin tonë. Ky projekt sikur të kishte bashkëpunim me Kryetarin e Komunës do ta kishim përkrahur, përndryshe nuk e përkrahim punën e tij. Komisioni të dal dhe të procedojë kur të krijohen kushtet të angazhimit”, pohoi anëtari Dedaj.

Haxhi Ibishi, sqaroi se ky projekt është pilot-projekt.

Sokol Bashota, theksoi se janë edhe 49 fshatra pa përfaqësues. “Çfarë zgjedhje është kjo? Asfare! Të krijohen kushtet të zgjedhën përfaqësuesit të fshatrave. Të shkohet me zgjedhjen e vetëm 5 kryetarëve nuk është hallkë e atij zinxhiri”, shtoi kryetari Bashota.

Ramush Agushi, theksoi se duhet ditur çfarë duhet vepruar, a janë lajmëruar fshatrat? “Të sqarohemi, të dimë çfarë të bëjmë”, shtoi anëtari Agushi.

Pjetër Coli, tha se po flitet për çështje financiare, është e pakuptueshme. “Mendoj që është mirë që të sigurohen mjetet dhe të procedohet me zgjedhjen e këtyre këshillave”, shtoi anëtari Coli.

Halil Desku, theksoi se e tha mirë kryetari, trupat që ne i kemi formuar duhet vepruar. “Një pilot – projekt me 4 fshatra nuk zgjedh problemin. Mendoj që ministria të ndihmojë komunat për zgjedhjen e këtyre përfaqësuesve të këtyre këshillave”, shtoi anëtari Desku.

Petrit Palushi, tha se nuk kemi të drejtë ta akuzojmë ministrinë e pushtetit lokal, sepse ajo nuk mund të pret pa kufi.

Fadil Gashi, tha se duhet falënderuar OJQ “Koha” që ka ndihmuar në procesin. “Po bëjmë përpjekje për ta gjetur ligjshmërinë. OJQ “Koha” e monitoruar përmes Kuvendit është pjesë e

procesit. Pilot – projekti është kur fillon diçka. Atesti s'na lidhë me ministrinë. Që sa vite kemi tentuar për një rregullore, kemi planifikuar edhe me mundësi të buxhetit. Kemi kërkuar edhe kompensim për kryetarët dhe anëtarët e këshillave. Mund të vazhdojnë të dyja pa lënduar njër-tjetrën. Nuk mund t'ia lëmë në dorë një OJQ-je. Nëse ministria i ka dhënë mandat OJQ-së nuk është në rregull. Telashet i kemi me sigurimin e buxhetit. Kur te merremi vësh për kompensim tjera zhvillime ndodhin. Aty ku ka kompensim ka edhe angazhim. Shikoni seancat e jashtëzakonshme të Kuvendit ku s'ka kompensim, nuk ka as pjesëmarrje të anëtarëve ose një pjesëmarrje e vogël. Mandati nuk guxon për të qenë i dikujt tjetër, por të mos ndërpritet bashkëpunimi i OJQ-së si monitoruese dhe të mos përzihet në angazhimet tona. Të bashkëveprohet”, ka konstatuar anëtari Gashi.

Sokol Bashota, theksoi se OJQ është pjesë e këtij projekti, të jetë monitoruese, të sqarohet. “Nuk jemi të interesuar të zgjedhën vetëm 4 kryetarë të fshatrave. Drejtoria e Financave duhet gjetur mjetet. Të merret një vendim”, ka shtuar kryetari.

Haxhi Ibishi, tha se le të mbetet për t'u sqaruar.

Qamile Qitaku, theksoi se po që se zbatohet ky projekt asgjë nuk na dëmton. “Besoj që qeveria jonë është në nivel. Ne duhet bashkëpunuar me qeverinë dhe OJQ-në. Komisioni është i njoftuar, prandaj mendoj që nuk ka asgjë te keqe. Pa pilot-projekt nuk mund të kryhet asnjë punë”, ka pohuar anëtarja Qitaku.

Halil Desku, theksoi se konkluzioni ynë i përbashkët është që të shtyhet. “Ne jemi të gatshëm të fillojmë, le të prolongohet kjo punë. Ne kemi nisur këtë punë, le të shtyjme, bisedojmë më vonë”, shtoi prof.. Desku.

Haxhi Ibishi, sqaroi çështjen. “Elbasani ka biseduar tri herë me mua, nuk ka asgjë që ka të bëjë me qëllim të keq.

Elbasan Racaj, përfaqësues i OJQ “Koha” në mënyrë kronologjike sqaroi çështjen rreth pilot-projektit për zgjedhjen e këshillave për katër fshatra të Komunës, donacion i fituar nga Ministria e Pushtetit Lokal. “Ju faleminderit që më dhatë fjalën! Është një nder për mua t'u drejtohem sot. Megjithatë unë, pa humbur kohë, do futem drejt në temë. Ne si organizatë jo qeveritare kemi paraqitur një projekt propozim pranë Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe na është ofruar një grant i vogël për zgjedhjen e katër këshillave lokale përmes nënshkrimit të një Marrëveshje Mirëkuptimi. Ne, në një fazë të dytë kohore, kemi njoftuar Komisionin Komunal për zgjedhjen e këshillave lokale si dhe kemi organizuar takimet e duhura në zyrën e Kryesuesit të Kuvendit Komunal në kohën e duhur. Ne nuk e kemi njoftuar kryetarin e Komunës pasi që Rregullorja për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatra, Vendbanim dhe Lagje Urbane nuk i jep asnjë funksion kryetarit të komunës në këtë rast. Këshilltarët e Kuvendit Komunal thirren në rregullore e megjithatë duket se ose kanë harruar se çfarë kanë miratuar në Janar të vitit 2015 ose nuk e kanë lexuar aspak këtë rregullore. Ne si organizatë vetëm kemi dashur të fillojmë procedurën e zbatimit të kësaj rregulloreje, kurse mos zbatimi i deritanishëm i së njëjtës është me fajin tuaj pasi që rregullorja në një nga nenet e saja përcakton se si rregullore

duhet të zbatohet brenda gjashtë muajve që nga miratimi i saj. Këto zgjedhje në bazë të kësaj rregullore mund të legjitimohen edhe me vetëm praninë e njërit nga këshilltarët e Komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokale dhe nuk ka asnjë konflikt interesi në këtë rast. Granti i ofruar nga MAPL nuk e kalon shumën prej 1,050.00 euro në këtë moment, andaj ne si organizatë e kemi pasur të pamundur të përfshijmë të gjitha fshatrat në këtë proces. Unë po i drejtohem këshilltarit z.Dedaj se ka qenë e pamundur të përfshijmë të gjitha fshatrat si rezultat i buxhetit të vogël, andaj nëse ju i ofroni të hollat tuaja nga xhepi juaj ne jemi në gjendje të organizojmë procesin zgjedhor në tërë territorin e Komunës së Klinës”, ka theksuar z. Racaj.

Sokol Bashota, theksoi që nuk guxon për t’i gjykuar këshilltarët e KK në foltore. “Kjo iniciativë juaja është konflikt interesi. Asambleja komunale miraton aktet ligjore Kryetarit të Komunës i hynë në punë kryetarët e fshatrave. Kush merr përsipër ngatërresat që mund të ndodhin gjatë zgjedhjeve të këtyre kryetarëve dhe këshillave, askush përpos nesh. Ka raste të shumta nëpër komunitat tjera ku kanë ndodhur raste të shumta të incidenteve gjatë këtyre zgjedhjeve. Qysh sot do t’i shikojë mundësitë e financimit për t’i zgjedhur kryetarët e fshatrave”, tha kryetari Bashota.

Tunë Dedaj, tha se e ka siguruar ministria pagesën e atyre kryetarëve dhe këshillave, atyre ju takon pagesa.

Enver Berisha, prezantoi rezultatet e analizave të ujit, sipas kërkesës së bërë nga anëtari i AKR-së, z. Avni Gashi.

“Analizat tregojnë se ujët është i pijshëm, mund t’ju fotokopjomë dhe t’ju shpërndajmë”, dha nënkryetari Berisha.

Filloreta Berisha, tha se këtyre analizave ju besoj po që se janë dalë nga pompa, - tha Dr. Berisha.

Enver Berisha, dha sqarime shtesë rreth analizave të ujët të pijshëm.

Tunë Dedaj, tha se ju besoj analizave, ujët është i pijshëm, mirëpo menaxhimi ishte tepër i dobët. Kryetari t’ju merr të drejtën e menaxhimit”, tha anëtari Dedaj.

Haxhi Ibishi, tha se jemi të prirë t’ju besojmë institucioneve tona.

Sokol Bashota, foli rreth çështjes në shqyrtim. Kryetari Bashota tregoi pikat nga janë marrë analizat e ujët të pijshëm.

Ndue Shabanaj, në emër të Komisionit për ndarjen e bursave për studentë foli rreth punës së këtij komisioni rreth ndarjes së bursave për studentë të Komunës së Klinës. “Kemi shpallur listën kush është përfitues dhe kush s’është përfitues. Ne ju kemi përmbajtur kriterëve, meqenëse mund të ketë edhe ndonjë pakënaqësi. Ky Kuvend duhet të zgjedhë edhe një komision për shqyrtimin e ankesave. E drejta e ankesës është për çdo kandidat që ka aplikuar në konkursin e shpallur”, ka sqaruar prof. Shabanaj.

Haxhi Ibishi, tha se me 2/3 të votave të anëtarëve në Kuvend mund të thyhet rregullorja.

Fadil Gashi, theksoi se biem ndesh me një komision, a ka Komuna Komision për ankesa?

Tunë Dedaj, tha se është mirë për t'u formuar ky komision.

Skënder Merturi, pohoi se jam pro formimit të këtij komisioni.

Kryesuesi vuri në miratim propozimin për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve që kanë konkurruar për bursa të studentëve.

Me vota unanime (25) u miratua propozimi për formimin e komisionit.

Kryesuesi kërkoi që të procedohet me propozimet:

Tunë Dedaj - propozoj Vlora Tafilajn

Halil Desku – propozoi Pjetër Colin.

Sokol Bashota – propozoi Suzana Gjergji.

Kryesuesi vuri në miratim propozimet.

Me vota unanime (25), u formua komisioni në këtë përbërje:

1. Vlora Tafilaj- kryetare e komisionit
2. Pjetër Coli – anëtar
3. Suzana Gjergji- anëtare


Kryesuesi falënderoi për kontributin e dhënë.

Seancën e konstatoi të mbyllur.

Seanca përfundoi në orën 14:00.

Procesmbajtësi,

Mikel GOJANI



Kryesuesi i Kuvendit,
Dr. Haxhi IBISHI

